

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. I. nga komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson E. A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, duke vendosur përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2351/2013 datë 13.9.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.2.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit A. I., nga Komuna e Lipjanit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 2351/2013 datë 13.9.2016.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 2351/2013 datë 13.9.2016, refuzohet ankesa e të autorizuarit të paditësit A. I., Komuna e Lipjanit – avokati E.A. nga Prishtina dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr. 255/2010 datë 27.5.2013, me të cilin në pjesën e I të dispozitivit, refuzohet kërkesëpadia e precizuar e paditësit në të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguajë shumën prej 28.500 €, në emër të dëmit të shkaktuar material – të rrënimin të objektit – lokalit afarist i cili gjendet në Lipjan, në Qendrën e zejtarëve “...” p.n., në sipërfaqe prej 22.60 m2, të vendosur në një pjesë të ngastrës kadastrale nr. ..., zk Lipjan si dhe t’ia paguajë shumën prej 6.893,00 € , në emër të fitimit të humbur, për shkak të pamundësisë të ushtrimit të veprimtarisë tregtare për periudhën prej 15.5.2010 e gjer më 29.4.2013, të gjitha këto me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 1.5.2013 e gjer te pagesa definitive, si e pabazuar. Në pikën II të dispozitivit, është vendosur që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpadija e paditësit si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës ose të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në kërkesëpadi kërkon kompensimin e dëmit material dhe fitimin e humbur, për shkak të rrënimin të objektit-lokalit afarist në Lipjan, në Qendrën Zejtare në ish rrugën “...” e tani “...”, në sipërfaqe prej 22.60 m<sup>2</sup>, të vendosur në një pjesë të ngastrës kadastrale nr. ..., zk Lipjan. Paditësi në padi pohon se këtë lokal afarist e ka blerë me kontratën për shitblerjen e patundshmërisë të datës 10.7.2001, nga shitësja H. O., nga fshati ..., e të cilën lokal e ka shfrytëzuar pandërprerë deri kur nga e paditurës është rrënuar. BVI për Banim në Lipjan me aktvendimin nr. ..., të datës ..., fillimisht këtë lokal ia ka dhënë në shfrytëzim H. O., për kryerjen e punëve zejtare. Nga procesverbali i komisionit për pranimin teknik të objekteve në ndërtim të Qendrës Tregtare në Lipjan të datës 2.7.1981, shihet se lokalin të cilin e ka shfrytëzuar paditësi, hyn në kuadrin e objekteve ndërtimore montuese, i cili ka qenë i vendosur në ngastrën kadastrale nr. 1998 zk Lipjan, e evidentuar si pronë shoqërore, shfrytëzues Hekurudhat e Kosovës.

E paditura me vendimin nr. 3051 të datës 29.5.2009, ka aprovuar planin urban për rregullimin e qytetit në Lipjan ku është paraparë që në sipërfaqen e paluajtshme ku është vendosur edhe lokali afarist kontestues të rregullohet parku i qytetit. E paditura me Aktvendimin për rrënimin e objektit të përkohshëm, garazhin, kioskën etj nr. ..., të datës ..., shfrytëzuesit e objekteve të përkohshme në mesin e të cilëve edhe paditësin e kanë njoftuar se duhet ta lirojnë hapësirën, ku ka qenë i vendosur lokali afarist kontestues, me qëllim të realizimit të planit urbanistik të qytetit, për ndërtimin e parkut.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si të tillë e refuzoj këtë për faktin se objekti afarist kontestues ka qenë i karakterit të përkohshëm në bazë të vendimit të paditurës ..., të datës ..., ku është paraparë që shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm pas skadimit të kohës për të cilën është lëshuar leja për vendosjen e objektit të përkohshëm ose para skadimit për të cilën është dhënë leja, nëse paraqitet nevoja për realizimin e planit urbanistik. E paditura mund të bie vendim për largimin e objekteve me karakter të përkohshëm dhe pronari apo shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm obligohet që brenda afatit prej 8 ditësh me shpenzimet e veta ta largoj objektin pa të drejtë kompensimi të shpenzimeve.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë e paditura nuk ka pasur obligim ligjor për eksproprijimin e lokalit afarist për faktin se ato objekte jepet leja komunale e përkohshme dhe me aprovimin e planit urbanistik apo me korigjimin e planit urbanistik ekzistues, palët kanë ditur apo është dashur të dinë se objektet e tyre të përkohshme të ndërtuara me material të dobët, duhet të rrënohen me shpenzimet e vetë palës.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm. Ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat ankesa pretendon, andaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë në bazë të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kotestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare e as të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e vendimit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Ashtu sikur të dy gjykatat edhe kjo Gjykatë mendon se me refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit kjo për faktin se objekti afarist kontestues ka qenë objekt i karakterit të përkohshëm, e ndërtuar me material të dobët, e vendosur në një pjesë të ngastrës kadastrale ..., zk Lipjan, e cila sipërfaqe e tokës është tokë e

urbanizuar me të cilin qeveris komuna konform nenti 10 të Ligjit mbi Toka Ndërtimore. Me vendimin e të paditurës ..., të dt. ..., publikuar në GZ të KSAK ne 4/1983 (i cili vendim ka qenë në fuqi në kohën kur i është ndarë lokali afarist shfrytëzueses Hyzeme Nezirit,) objekti kontestues konsiderohet si objekt montazh. E të paditurës me këtë vendim ka paraparë që toka për vendosje të objektit të përkohshëm jepet me kohë të caktua që nuk mund të jetë më e gjatë se 3 vjet. Pronari i objektit është i obliguar që pas skadimit të kohës së caktuar në leje të njëjtin ta largoj me shpenzimet e veta dhe pa të drejtë kompensimi .Me këtë vendim po ashtu është paraparë që organi administrativ i cili ka lëshuar lejen për vendosjen e objektit , mund të bijë aktvendim për largimin e objektit,edhe para skadimit të afatit të caktuar në leje nëse është e nevojshme në qëllim të realizimit të planit urbanistik , ndërtimor të objektit të karakterit të përkohshëm.

E paditura me vendimin nr. ... i datës ..., ka aprovuar planin urban për rregullimin e qytetit të Lipjanit, ku është paraparë që në sipërfaqen e paluajtshmërisë ku është vendosur edhe lokali afarist të rregullohet parku i qytetit të Lipjanit. Me aktvendimin nr. ..., datë ..., e paditura i ka njoftuar shfrytëzuesit e objekteve të përkohshme në mes të cilit edhe paditësin, që janë të obliguar që ta lirojnë ngastrën kadastrale nr. ... zk Lipjan, ku ka qenë vendosur lokali afarist kontestues. Meqenëse, paditësi nuk e ka rrënuar objektin dhe nuk ka treguar vullnet të kryejë urdhrat nga vendimi i të paditurës me këtë të evitoj dëmet apo ta zvogëlojë e paditura nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit ashtu si drejtë kanë vlerësuar të dy gjykatat kur e kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit.

Prandaj, janë të pabazuara parashtrimet në revizion se aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe jo në kundërtënie me arsyetimin, në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të plota, të mjaftuara për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Parashtrimet në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur ka vlerësuar se paditësit nuk i takon e drejta për shpërblimin e dëmit në mënyrën që është kërkuar në kërkesëpadi për arsye se komuna e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit dhe fitimit të humbur, kjo Gjykatë pretendimet e tilla i cilësoi si të

pabazuara dhe si të tilla i refuzoi për faktin se, paditësi nuk ka arritur ta argumentojë përgjegjësinë e të paditurës për kompensimin e dëmit, ndërsa kjo Gjykatë nga provat e administruara ka vërtetuar se e paditura nuk ka obligim ligjor për kompensimin e dëmit material në bazë të dispozitës së nenit 154 par. 1 dhe 158 të LMD, për faktin se të gjitha veprimet e të paditurës janë marrë në mbështetje të bazës ligjore në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore për realizimin e kësaj forme të dëmit pasi që paditësi ka dështuar që të dëshmojë se ka pasur dëm për shkak të veprimit të palejuar dhe të kundërligjshëm të paditurës dhe se e paditura për veprimet e saja është përgjegjëse për shkaktimin dëmit që këto veprime që janë ndërmarrë, janë të kundërligjshme, për dëmin e shkaktuar të jetë fajtor e paditura.

Nga shkresat e lëndës kjo Gjykatë vlerësoi se paditësi po ashtu nuk ka provuar me asnjë provë ekzistimin e mundësisë së fitimit të humbur që ka mund të pritet në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt ose sipas rrethanave normale të gjërave që do të realizonte, ndërsa realizimi i të cilave është penguar dhe pamundësuar nga veprimi i dëmshëm i të paditurës.

Përndryshe për arsyet e dhëna nga kjo Gjykatë dhe aspekti i zbatimit të të drejtës materiale aktgjykimet e të dy gjykatave janë të ligjshme dhe çdo pretendim lidhur me zbatimin e gabuar të të drejtës materiale është i papranueshëm.

Nga sa u tha më sipër e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.342/2016, më 15.2.2017

Kryetare e kolegjit,

Gyltene Sylejmani